

KRONIKË E ZEZË

Një polic kosovar kapet në kufi me 1.074 fishekë



Një polic është zënë në orët e para të së hënës në pikën kufitare në Vermicë, teksa po bartte ilegalisht municion për gjueti.

Inspektorati Policor i Kosovës ka njoftuar se për policin, që ishte jashtë detyrës zyrtare kur u kap, është rekomanduar suspendimi, ndërkohë që në bashkëpunim me prokurorin është hapur rasti me dyshimin se është kryer vepra penale “Importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materialeve plasëse”.

IPK-ja bëri të ditur se bëhet fjalë për 1074 fishekë të pushkës së gjuetisë.

“Rasti do të hetohet në procedurë të rregullt, kurse nga IPK-ja është dhënë rekomandimi për suspendimin e zyrtarit të përfshirë në këtë rast”, thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#POLICI #KUFİ #VERMICE #FISHEKË

15 gusht 2022, 12:34

Shpërndaje në



- Arrestohet i dyshuari në Podujevë, mashtroi duke i marrë 3.000 euro për vizë pune
- Ngacmoi seksualisht një të mitur, arrestohet taksisti ilegal në Prishtinë
- Konfiskohen dy armë në dy ahengje në Mitrovicë e Skenderaj
- Vdes një fëmijë në Istog pasi u godit nga vetura
- Sylejman Ahmeti dënohet me 24 vjet e 10 muaj burgim për vrasjen e shokut
- Arrestohet një 14-vjeçar në Rahovec për 25 kallëzime të rreme
- Përdorimi i armëve në ahengje, tetë të arrestuar brenda një dite në Kosovë

TË TJERA




Një banori në Fushë-Kosovë iu hakua llogaria, i vidhen mbi 3.800 dollarë



Gati 25 vjet burgim për Sylejman Ahmetin që vrau shokun për 20 euro borxh



Ndalohen 10 persona të maskuar në kryeqytet, gjobiten për prishje të rendit



Dënohen me 900 euro gjobë tre të akuzuarit që rrahën gjyqtarin gjatë ndeshjes së futbollit në Prizren